



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

V E N D I M

Nr. 756, datë 23.9.2020

PËR

**FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRBASHKËT
TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE
TË PËRBASHKËTA PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, për organizimin e përbashkët të mëimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë, datë 23.3.2015, përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve, si më poshtë vijon:
 - a) 5 (pesë) përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Kosovës dhe Ministria për Punët e Jashtme dhe Diasporën së Republikës së Kosovës;
 - b) 5 (pesë) përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë dhe ministri i Shtetit për Diasporën.
2. Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën ka për detyrë:
 - a) hartimin e standardeve të teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën;
 - b) hartimin e paketës së dokumenteve për procedurat e konkurrimit për tekstet mësimore të përbashkëta për diasporën;



- c) përcaktimin e kriterëve të recensuesve të teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën;
- ç) miratimin e teksteve mësimore të përbashkëta fituese për diasporën.
3. Qendra e Botimeve për Diasporën kryen funksionet e sekretariatit teknik të Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën.
4. Shpenzimet për mbarëvajtjen e punës së Komisionit, përfshirë udhëtimin, akomodimin dhe dietat, për realizimin e mbledhjeve zyrtare të anëtarëve të Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës, për pagesën e recensuesve të teksteve dhe proceseve të tjera në shërbim të procesit, mbulohej nga buxheti i miratuar i Qendrës së Botimeve për Diasporën të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Pagesat e pikës 4, të këtij vendimi, propozohen rast pas rasti nga drejtori i Qendrës së Botimeve të Diasporës dhe miratohen nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën.
6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Shtetit për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSK R Y E M I N I S T R I
ERION BRAÇE

MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

PANDELI MAJKO